



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Op. Dep.	2-D/DPK
Nr. i titullit titull shkrimi Nr. pages	02
Nr. Prot. B. Prot. Prot. No.	01-2369/13
Data Datum Date	07-08-2013



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 (paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 07.08.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-1895/13, për z. Rustem Abiti – Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-1895/13, për Zyrtarin e Lartë, z. Rustem Abiti, Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa në Komunën e Mitrovicës dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartpërmendur, zyrtari i lartë z. Abiti është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (me datë 10.07.2013), pas së cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë. Me këtë rast ai është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet të cilat duhet të bëj për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Abiti, në këtë takim ka deklaruar se brenda afatit ligjor do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar në biznesin privat dhe do të vazhdoj të ushtroj funksionin e tij publik.

Ndërkohë, z. Abiti ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03/2357/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka hequr dorë nga pozita e personit të autorizuar që kishte në "ENIMEX" Sh.P.K., për të ushtruar funksionin e tij publik në Komunën e Mitrovicës, me çka ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

